РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
МИНИСТЕРСТВО ЗА СОЦИЈАЛНА ПОЛИТИКА, ДЕМОГРАФИЈА И МЛАДИ - СКОПЈЕ
MINISTRIA E POLITIKËS SOCIALE E DEMOGRAFISË DHE E TË RINJVE - SHKUP
Бр. / Nr. 10-8345/1
24-12-2025 20 год. / viti

MINISTRIA E POLITIKËS SOCIALE, DEMOGRAFISË DHE TË RINJVE

publikon

# THIRRJE PUBLIKE PËR VITIN 2026

Për dorëzimin e aplikacioneve (kërkesave) nga ana e komunave mbi financimin e projekteve për ndërtimin, mbindërtimin, rikonstruimin dhe përshtatjen e objekteve për vendosjen e shërbimeve dhe rritjen e kapaciteteve të ofruesve ekzistues për shërbime të këshillimit, shërbime në shtëpi, shërbime në komunitet dhe shërbime për mbrojtje jashtëfamiljare në përputhje me interesin më të mirë të përfituesit me mjete nga Buxheti i Ministrisë së Politikës Sociale, Demografisë dhe të Rinjve.

## Qëllimet e Thirrjes Publike

Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe të Rinjve, në drejtim të avancimit dhe të zhvillimit të shërbimeve sociale në nivel lokal dhe të përmirësimit të cilësisë dhe qasjes në shërbime në përputhje me nevojat e qytetarëve në rrezik social dhe përjashtim social, shpall Thirrje Publike për dorëzimin e aplikacioneve (kërkesave) nga ana e komunave mbi financimin e projekteve për ndërtimin, mbindërtimin, rikonstruimin dhe përshtatjen e objekteve për ngritjen e shërbimeve dhe rritjen e kapaciteteve të ofruesve ekzistues, dhe atë, për shërbime të këshillimit, shërbime në shtëpi, shërbime në komunitet dhe shërbimet për mbrojtje jashtëfamiljare në përputhje me interesin më të mirë të përfituesit me mjete nga Buxheti i Ministrisë së Politikës Sociale, Demografisë dhe të Rinjve.

## Mënyra e përzgjedhjes së projekteve të paraqitura

Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe të Rinjve do të sigurojë financim të projekteve për ndërtimin, mbindërtimin, rikonstruimin dhe përshtatjen e objekteve për ngritjen e shërbimeve dhe rritjen e kapaciteteve të ofruesve ekzistues për shërbime të këshillimit, shërbime në shtëpi, shërbime në komunitet dhe shërbime për mbrojtje jashtëfamiljare sipas kritereve, metodologjisë dhe kushteve të tjera të përcaktuara me akt të brendshëm -aktvendim të miratuar nga Ministri i Politikës Sociale, Demografisë dhe të Rinjve.

## Kriteret më të afërta për rangimin e projekteve të paraqitura

Kriteret e rangimit të projekteve për punimet e ndërtimit dhe/ose pajisjen e hapësirave për ndërtim, mbindërtim dhe përshtatje për rritjen e kapaciteteve për shërbime të këshillimit, shërbime shtëpiake, shërbime në komunitet dhe shërbime të mbrojtjes jashtëfamiljare për ofrimin e shërbimeve sociale të përfituesve të mbrojtjes sociale për aplikimet (kërkesat) e parashtruara nga komunat janë:

A. Përfshirja e planifikuar (numri i fëmijëve/personave) mbi zgjerimin e kapaciteteve për shërbime të këshillimit, shërbime në shtëpi, shërbime për komunitetin dhe shërbime për mbrojtjen jashtëfamiljare të përfituesve të mbrojtjes sociale sipas projektit të paraqitur të komunës në përputhje me programet vjetore për nevojat e qytetarëve të fushës së mbrojtjes sociale.

B. Përfshirja e planifikuar (numri i fëmijëve/personave) mbi zgjerimin e kapaciteteve për shërbime të këshillimit, shërbime në shtëpi, shërbime për komunitetin dhe shërbime për mbrojtjen jashtëfamiljare të përfituesve të mbrojtjes sociale në zonat rurale sipas programeve vjetore për nevojat e qytetarët në fushën e mbrojtjes sociale.

C. Mënyra e ofrimit të shërbimit social në përputhje me normën dhe standardin e përcaktuar për shërbim të caktuar social.

Ç. Pjesëmarrja financiare e komunës

Në përputhje të kritereve të përcaktuara më sipër, pikët totale arrijnë në 100 pikë, prej të cilave:

- Gjithsej 50 pikë për përfshirjen e fëmijëve/personave në shërbimin social të përcaktuar në komunë;
- Gjithsej 20 pikë mbi zgjerimin e kapaciteteve për shërbime të këshillimit, shërbime në shtëpi, shërbime në komunitet dhe shërbime për mbrojtjen jashtëfamiljare të përfituesve të mbrojtjes sociale në zonat rurale.
- Gjithsej 20 pikë për ofrimin e shërbimit nëpërmjet krijimit të qendrës komunale të shërbimit social.
- Gjithsej 10 pikë për pjesëmarrjen financiare të komunës për realizimin e projektit të parashtruar (% e vlerës së vlerësuar të projektit/aplikacionit)

**Për kriterin A,** pikët "përfshirja e fëmijëve/personave në shërbimet e këshillimit, shërbimet në shtëpi, shërbimet në komunitet dhe shërbimet për mbrojtjen jashtëfamiljare të përfituesve të mbrojtjes sociale" ndahen sipas përqindjes (%) së përfshirjes sipas "numrit të parashikuar të përfituesve në Aktin që rregullon normat dhe standardet për shërbimin konkret (përllogaritur si përqindje e përfshirjes së planifikuar të fëmijëve/personave me projektin e parashtruar të numrit të parashikuar në përputhje me standardet, për shërbimin konkret), dhe atë:

| % e përfshirjes | pikët |
|---|---|
| 95,01%-100,00% | 50 |
| 90,01%-95,00% | 45 |
| 85,01%-90,00% | 40 |
| 80,01%-85,00% | 35 |
| 75,01%-80,00% | 30 |
| 70,01%-75,00% | 25 |
| 65,01%-70,00% | 20 |
| 60,01%-65,00% | 15 |
| 55,01%-60,00% | 10 |
| 50,01%-55,00% | 5 |

**Për kriterin B,** "zgjerimi i kapaciteteve për shërbime të këshillimit, shërbime në shtëpi, shërbime në komunitet dhe shërbime për mbrojtje jashtëfamiljare të përfituesve të mbrojtjes sociale në zonat rurale sipas shkallës së zhvillimit të rajonit të planifikimit sipas indeksit zhvillimor", pikët ndahen për zonë rurale sipas indeksit zhvillimor të rajonit planor, nga të paktën 10 pikë për zonë rurale të rajonit planor me indeksin më të lartë të zhvillimit, deri në maksimum 20

pikë për zonë rurale nga rajoni i planifikimit me indeksin më të ulët zhvillimor, me distancë sipas indeksit zhvillimor të rajonit planor, si në tabelë:

| Rajoni planor | Pikët |
|---|---|
| Verilindor | 20,00 |
| Lindor | 15,47 |
| Vardarit | 15,34 |
| Jugperëndimor | 15,14 |
| Pollogut | 15,14 |
| Pellagonisë | 15,07 |
| Juglindor | 13,99 |
| Shkup | 10,00 |

**Për kriterin C**, 20 pikë u ndahen aplikantëve për projektet për të cilat "mënyra e ofrimit të shërbimit është përmes krijimit të qendrës komunale për shërbime sociale".

**Për kriterin Ç**, "pjesëmarrja financiare e komunës/kërkuesit për realizimin e projektit të dorëzuar", jepen maksimumi 10 pikë në përputhje të tabelës së mëposhtme:

| Përqindja e pjesëmarrjes financiare të aplikantit | |
|---|---|
| % | Pikët |
| më shumë se 50,00% | 10 |
| 45,01% - 50,00% | 9,5 |
| 40,01% - 45,00% | 9 |
| 35,01% - 40,00% | 8 |
| 30,01% - 35,00% | 7 |
| 25,01% - 30,00% | 6 |
| 20,01% - 25,00% | 5 |
| 15,01% - 20,00% | 4 |
| 10,01% - 15,00% | 3 |
| 5,01% - 10,00% | 2 |
| 2,51% - 5,00% | 1 |
| 2,10% 2,50% | 0,5 |
| 1,51%- 2,00% | 0,4 |
| deri 1,01% - 1,50% | 0,3 |
| 0,51% 1,00% | 0,2 |
| deri 0,50% | 0,1 |
| më pak se 0,50% | 0 |

### Dokumentacioni i nevojshëm

Paraqitja në Thirrjen Publike bëhet me dorëzimin e aplikacionit (Kërkesë) të plotësuar me dokumentacion të plotë të projektit për ndërtimin, mbindërtimin, rikonstruimin dhe përshtatjen mbi rritjen e kapaciteteve për shërbime të këshillimit, shërbime në shtëpi, shërbime në komunitet dhe shërbime për mbrojtje jasht-familjare të përfituesve të mbrojtjes sociale sipas aplikacionit

(dokumentacioni i specifikuar në Aplikacionin për Thirrjen Publike, përkatësisht: formulari i aplikimit, fletëpronësia, projekti bazë dhe specifikimi për pajisje).

Aplikacioni (Kërkesa) është pjesë përbërëse e Thirrjes Publike dhe publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Politikës Sociale, Demografisë dhe të Rinjveë www.mtsp.gov.mk.

**Burimi i mjeteve**

Mjetet për këtë qëllim do të sigurohen nga Buxheti i Ministrisë së Politikës Sociale, Demografisë dhe të Rinjve për vitin 2026 për shpenzime kapitale, Ndarja 150.01 nën-programi 4A, duke marrë parasysh edhe mundësitë e financimit nga burime të tjera.

**Afati dhe mënyra për zbatimin e procedurës**

Thirrja Publike është e llojit të hapur për parashtrimin e aplikacioneve deri me datën **12.01.2026** dhe është e publikuar në ueb-faqen zyrtare të Ministrisë së Politikës Sociale, Demografisë dhe të Rinjve www.mtsp.gov.mk.

Aplikacioni (Kërkesa) me dokumentacion të bashkëngjitur duhet të dorëzohet në arkiv ose me postë në Ministrinë e Politikës Sociale, Demografisë dhe të Rinjve në adresën rr. "Dame Gruev" 14, 1000 Shkup me shënimin "Thirrje Publike për financim të projekteve për ndërtimin, mbindërtimin, rikonstruimin dhe përshtatjen e objekteve për ngritjen e shërbimeve dhe rritjen e kapaciteteve të ofruesve ekzistues për shërbime të këshillimit, shërbime në shtëpi, shërbime në komunitet dhe shërbime të kujdesit jashtëfamiljar për përfituesit e mbrojtjes sociale".

Komunat, të cilat do ta dorëzojnë dokumentacionin e plotë bashkëngjitur me Aplikacionin, do t'i nënshtrohen shqyrtimit dhe vlerësimit për financim pas sigurimit të mjeteve nga radhët e Ministrisë.

Përparësi do të kenë komunat që për herë të parë aplikojnë për shërbim që nuk është zhvilluar në atë komunë.

Projektet e dorëzuara duhet të jenë në përputhje me normat pozitive ligjore dhe në përputhje me Rregulloret aktuale të Ligjit të Mbrojtjes Sociale.

***Shënim:***

***Fletëparaqitjet që mbërrijnë pas afatit të caktuar për dorëzim nuk do të shqyrtohen.***

***Nuk do të rangohen projektet në të cilat do të konstatohen lëshime nga rregulloret aktuale.***

Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe të Rinjve

APLIKACION (KËRKESË)
për
THIRRJEN PUBLIKE

Për dorëzimin e aplikacioneve (kërkesave) nga komunat për financimin e projekteve për ndërtimin, mbindërtimin, rikonstruksionin dhe përshtatjen e objekteve për ngritjen e shërbimeve dhe rritjen e kapaciteteve të ofruesve ekzistues për shërbime këshillimi, shërbime në shtëpi, shërbime në komunitet dhe shërbime për mbrojtjen jashtë-familjare në përputhje me interesin më të mirë të përfituesit me mjete nga Buxheti i Ministrisë së Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë

| **Arsyetim i shkurtër i kërkesës:** |
|---|
| |

Pjesa I – Informacione për Komunën – Kërkuese

I.1. KOMUNA: ____________________
I.2. Informacione kontakti

- Adresa: ____________________
- Telefoni: ____________________
- E-mail: ____________________
- Personi për kontakt: ____________________

**Pjesa 2 – Informacione për Projektin**

2.1. Lloji i shërbimit social (të rrethohet njëra nga kategoritë):

- Shërbimi i këshillimit;
- Shërbimi në shtëpi;
- Shërbimi në komunitet dhe
- Shërbimi për mbrojtje jashtë-familjare.

2.2. Grupi i synuar që do të mbulohet nga shërbimi (shtoni grupin e synuar sipas shërbimit )

| |
|---|
| |

2.3. Mënyra e ofrimit të shërbimit (rrethoni një nga metodat e dhëna më poshtë)

- **nëpërmjet krijimit të institucionit për mbrojtjen jashtë-familjare** (neni 117 i Ligjit për mbrojtjen sociale)
- **përmes themelimit të Qendrës komunale për shërbime sociale** (neni 119 i Ligjit për mbrojtjen sociale)
- **duke lidhur një marrëveshje me ofrues të licencuar të shërbimeve** (neni 127 i Ligjit për mbrojtjen sociale)

2.4. Lokacioni i objektit:

A) Zona urbane  B) Zona rurale

2.3. Lloji i ndërtimit:

A) Objekt i ri

B) Mbindërtim/zgjerim

C) Adaptimi/rikonstruksioni i hapësirës tjetër adekuate për shndërrim

Ç) Tjetër

2.4. Kapaciteti i objektit (përfshirja e planifikuar e fëmijëve/personave): ____________

Pjesa 3 – Të dhëna financiare për projektin

| | Vlera e përgjithshme e vlerësuar pa TVSH | TVSH | Vlera e vlerësuar me TVSH | Pjesëmarrja financiare e komunës (shuma me TVSH) | Pjesëmarrja financiare e komunës në shumë fikse |
|---|---|---|---|---|---|
| 3.1. PUNË NDËRTIMORE | | | | | |
| 3.2. PAJISJE | | | | | |
| GJITHSEJ (3.1.+ 3.2) | | | | | |

3.(*) Shuma matjes rrumbullakohet me mijëshen në vijim.

Pjesa 4 – Dokumentacioni i bashkangjitur (i detyrueshëm)

4.1. Fletë-pronësia për lokacionin e objektit (objekti duhet të jetë në pronësi të komunës ose të jetë caktuar për shfrytëzim)

4.2 Ekstrakt nga plani detaj urban ose Planit jashtë vendbanimit

4.3 Elaborat i të dhënave numerike

4.4 Për punimet ndërtimore:

4.4.a Nëse bëhet fjalë për ndërtimin e një objekti të ri apo mbindërtim: një projekt bazë me të gjitha fazat, mendim pozitiv nga IZIIS dhe llogaritjet paraprake me çmimet e projektimit për çdo fazë, të përgatitur nga projektues/zyre projektuese të autorizuara që posedojnë të gjitha të licencat e nevojshme dhe autorizimet dhe që janë regjistruar në Regjistrin Qendror për kryerjen e veprimtarisë përkatëse. Projektet bazë të dorëzuara duhet të rishikohen nga inxhinierë/firma të autorizuara për revizion që i posedojnë të gjitha licencat e nevojshme dhe janë të regjistruara në Regjistrin Qendror për kryerjen e veprimtarisë përkatëse dhe revizioni i projekteve duhet të dorëzohet si pjesë përbërëse e dokumentacionit të projektit. Projektet bazë të dorëzuara duhet të jenë në përputhje me normat pozitive ligjore dhe në përputhje me Rregulloret aktuale të Ligjit për mbrojtjen sociale. Nuk do të rangohen projektet në të cilat do të konstatohen lëshime nga rregulloret aktuale.

4.4.b Nëse bëhet fjalë për rinovim/përshtatje të një objekti: projekt për rinovim/rikonstruksion /përshtatje me të gjitha fazat e nevojshme në të cilat parashikohen ndryshime. Projekti duhet të përmbajë vizatime, një përllogaritje me çmimet e projektimit për çdo fazë dhe një përshkrim teknik, të përgatitur nga projektues/zyre projektuese të autorizuara, që i posedojnë të gjitha licencat dhe autorizimet e nevojshme dhe të regjistruara në Regjistrin Qendror për kryerjen e veprimtarisë përkatëse. Projektet e dorëzuara duhet të jenë në përputhje me normat pozitive ligjore dhe në përputhje me Rregulloret aktuale të Ligjit për mbrojtjen sociale. Nuk do të rangohen projektet në të cilat do të konstatohen lëshime nga rregulloret aktuale.

4.5 Për pajimin - përllogaritja e paramatjes për sasinë dhe çmimin e mobilimit sipas çmimeve reale të tregut që do t'i përmbajë të gjitha pozicionet e pajisjeve të specifikuara në pjesën e mobilimit të hapësirave - objekteve.

4.6. Kontrata për ofrimin e shërbimit ndërmjet komunës dhe ofruesit të shërbimit, nëse ofrohet përmes ofruesit, (nëse ofruesi nuk ka leje për ofrimin e shërbimit, ai është i detyruar ta ofrojë atë përpara fillimit të ofrimit të shërbimit ).

Parashtrues i Kërkesës

VV

____________________